

Mbi vaksinimin kundër hepatitit B

Hepatiti B është një infeksion i mëlçisë, i cili shkaktohet nga virusi i hepatit B (HBV). Ky virus transmetohet nëpërmjet gjakut apo lëngjeve të trupit të një njeriu të infektuar (p.sh. nëpërmjet marrëdhënieve seksuale). Duke qenë se gjaku dhe produktet e gjakut në vendet e industrializuara në përgjithësi testohen për patogjenë që shkaktojnë sëmundje dhe në këtë mënyrë konsiderohen të sigurt, kontaktet intime luajnë një rol të rëndësishëm në transmetim. Për rrjedhojë, rreziku shtohet me fillimin e pubertetit. Transmetimi i patogjenit të fëmija mund të ndodhë edhe nga një grua shtatzënë e infektuar kronike me virusin e hepatitit. Për këtë arsye duhet që të gjitha femrat shtatzëna të kryejnë analizat. Nëse analiza rezulton pozitive, i sapolinduri trajtohet menjëherë pas lindjes me profilaksi imunologjike.

Hepatiti B fillon me shqetësime gastrointestinale ose të ngjashme me gripin, këputje dhe temperaturë. Pas kësaj, urina mund të marrë ngjyrë kafe, feçet humbin ngjyrën dhe mund të shkaktohet zverdhje e lëkurës dhe konjunktivit i syve (verdhës). Afërsisht 1 për qind e të sëmurëve vdesin, deri në 10 për qind e të rriturve të infektuar kthehen në të sëmurë kronikë (te foshnjat 90 për qind), ndërkohë që virusi qëndron në trup. Virusin e hepatitit B mund të çojë në një infeksion kronik edhe kur nuk ekzistojnë simptoma të dukshme të një sëmundjeje. Të sëmurët kronikë janë burim infeksioni për mjedisin që i rrethon. Në Gjermani, afërsisht 0,3 deri në 0,8 për qind e popullsisë janë të infektuar kronikë me HBV; në vende të tjera – p.sh. në vendet afrikane dhe aziatike – numri i të infektuarve kronikë është shumë më i lartë. Nëse sëmundja është kronike, mund të sjellë si pasojë afatgjatë cirrozën e mëlçisë dhe/ose karcinomën hepatoqelizore.

Nuk disponohet një trajtim specifik për hepatitin B akut. Mbrojtja e vetme është marrja në kohë e vaksinës mbrojtëse.

Vaksinat

Vaksinat kundër hepatitit B përmbajnë komponentë nga mbështjellja e virusit të hepatitit B, të cilët përftohen nëpërmjet teknikave të inxhinierisë gjenetike duke përdorur mikroorganizma dhe që në fund pastrohen me metoda moderne. Nëse merren rregullisht, ato sigurojnë një imunitet afatgjatë, çka do të thotë mbrojtje nga sëmundja e hepatitit B.

Vaksina njëvalente e hepatitit B merret 3 herë. Mjeku që do të bëjë vaksinën mund t'ju informojë për harkun kohor të marrjes së këtyre vaksinave, për fillimin dhe kohëzgjatjen e mbrojtjes nga vakcina dhe, sipas rastit, për marrjen e vaksinave të nevojshme përforcuese. Vaksina kundër hepatitit B mund të merret njëkohësisht me vaksinat e tjera. Vaksina injektohet (injeksion intramuskulor ose, sipas rastit, me injeksion nën lëkurë). Injeksioni bëhet vetëm në pjesën e sipërme të krahut ose në pjesën anësore të kofshës. Te personat me rrezik të lartë infektimi, p.sh. te personeli mjekësor, reagimi imunologjik monitorohet pas përfundimit të vaksinimit primar dhe, sipas rastit, bëhet rivaksinim. Një test për imunizim këshillohet edhe te pacientët me sistem imunitar të dëmtuar (p.sh. për shkak të një terapie kundër kancerit).

Përveç vaksinës njëvalente për të cilën folëm, e cila mbron vetëm kundër hepatitit B, disponohen edhe vakcina polivalente për foshnja dhe fëmijë të vegjël, të cilat mbrojnë njëkohësisht edhe kundër sëmundjeve të tjera (p.sh. vakcina shumëvalente). Për këto vakcina të kombinuara disponohen fletë informuese të veçanta.

Kush duhet të vaksinohet?

1. Sipas kalendarit të vaksinimit, vakcina kundër hepatitit B këshillohet të bëhet nga djemtë dhe vajzat pas moshës 8-javëshe. Për këtë qëllim, shërbejnë edhe vaksinat e kombinuara të përmendura tashmë. Kryerja e mëvonshme e imunizimit, kur nuk është kryer në foshnjëri, është e mundur dhe këshillohet të kryhet në çdo kohë.
2. Të porsalindurit, nënat e të cilëve janë të infektuara me virusin e hepatitit B, vaksinohen menjëherë pas lindjes dhe marrin imunoglobulinë (E rëndësishme: Të mendohet për plotësimin e vaksinimit primar).
3. Personat tek të cilët, për shkak të një problemi ekzistues ose të pritshëm të sistemit imunitar apo për shkak të një sëmundje ekzistuese, pritet një ecuri e vështirë e hepatitit B, p.sh. të infektuarit me HIV dhe/ose hepatit C, pacientët me sëmundje të mëlçisë, pacientët me dializë dhe të tjerë.
4. Personat me rrezikshmëri të lartë, jo për shkak të profesionit, p.sh. nëpërmjet kontaktit me të infektuarit me hepatit B në familje dhe komunitet, sjelljes seksuale me rrezik të lartë infektimi, konsumuesit e drogave intravenoze, të burgosurit, ndoshta pacientët në institucionet psikiatrike.
5. Personat me rrezikshmëri të lartë për shkak të profesionit, p.sh. personeli mjekësor dhe dentar (dhe në laborator, personeli sanitar dhe praktikantët), ndihma e shpejtë, personeli i policisë, personeli i institucioneve me rrezikshmëri të lartë, p.sh. burgjet, qendrat e pritjes së azilantëve, institucionet për trajtimin e personave me aftësi të kufizuara.
6. Udhëtarët në zonat tropikale dhe subtropikale në të cilat hepatiti B ndeshet shpesh; nevojitet vlerësimi individual i rrezikut.

Kush nuk duhet të vaksinohet?

Personat që po trajtohen për shkak të një sëmundje akute me temperaturë (mbi 38,5°C) nuk duhet të vaksinohen. Vaksinimi duhet të kryhet më vonë, menjëherë pasi janë zhdukur simptomat. Gjatë shtatzënisë duhet kryer vaksinimi vetëm në rastet kur ka një rrezik real të dallueshëm infeksioni. Nëse keni mbindjeshmëri ndaj ndonjë komponenti të vaksinës ose nëse pas një vaksinimi të mëparshëm kundër hepatitit B ju janë shfaqur shenja të sëmundjes, mjeku juaj do t'ju këshillojë në lidhje me domosdoshmërinë apo mundësitë e një vaksinimi të mëtejshëm.

Sjellja pas vaksinimit

Personi i vaksinuar nuk ka nevojë për mbrojtje të veçantë, megjithatë duhen shmangur sforcimet e pazakonta fizike deri në 3 ditë pas vaksinimit. Te personat me prirje për reagime kardiovaskulare ose me histori alergjie të menjëhershme, mjeku duhet të informohet përpara vaksinimit.

Reaksione të mundshme lokale dhe të përgjithshme pas vaksinimit

Pas vaksinimit, përveç synimit të rritjes së imunitetit dhe në këtë mënyrë mbrojtjes nga sëmundja, në rreth 10 për qind të personave të vaksinuar mund të shfaqen skuqje ose ënjtje me dhimbje në vendin e vaksinimit. Ky reagim është tregues i përballjes normale të trupit me vaksinën dhe ndodh kryesisht brenda 1 deri 3 ditëve, dhe rrallë zgjat më shumë. Rrallë hasen ënjtje të nyjave limfatike. Janë të rralla simptomat e përgjithshme, si ngritja e lehtë apo mesatare e temperaturës, ethet, dhimbjet e kokës dhe të gjymtyrëve (dhimbje muskujsh dhe mesi) ose këputja. Gjithashtu mund të shfaqen simptoma gastrointestinale (të përziera, të vjella, diarre). Pas vaksinimit mund të haset një rritje e vlerave të enzimave të mëlçisë në mënyrë sporadike. Në përgjithësi, reaksionet e lartpërmendura janë kalimtare dhe largohen shpejt dhe pa pasoja.

A janë të mundshme komplikimet nga vaksinimi?

Komplikacionet nga vaksinimi janë pasoja shumë të rralla të shkaktuara nga vaksinimi, të cilat shkojnë përtej një reaksioni normal dhe që e rëndojnë dukshëm gjendjen shëndetësore të personit që do të vaksinohet. Në raste të veçanta janë raportuar komplikacione të sistemit nervor (p.sh. neurite, paralizë e përkohshme) dhe zvogëlim i numrit të trombociteve; lidhja shkakore e këtyre simptomave me vaksinimin është e diskutueshme.

Këshillimi për efektet anësore të mundshme me mjekun e vaksinimit

Përveç kësaj fletëpalosjeje, mjeku juaj ju ofron një bisedë informuese.

Nëse pas një vaksinimi shfaqen simptoma që i tejkalojnë reaksionet e përkohshme lokale dhe të përgjithshme të sipërpërmendura, mjeku i vaksinimit është gjithmonë në dispozicionin tuaj.

Ju mund të kontaktoni me mjekun e vaksinimit:

Deklaratë për mosmbajtje përgjegjësie

Përkthimi i origjinalit të fletës informuese (publikuar në: 10.2014) është kryer me lejen e Grünen Kreuzes e.V. (Kryqi i Gjelbër Gjerman) me kërkesë të Institutit "Robert Koch". Teksti në gjuhën gjermane ka përparësi. Nuk mund të mbahet asnjë përgjegjësi për gabime të mundshme në përkthim, e aq më pak për aktualitetin e përkthimit në fjalë në raste të rishikimeve të mëvonshme të materialit në gjuhën gjermane.

Emri _____

Name

Vaksinimi mbrojtës kundër hepatitis B*Schutzimpfung gegen Hepatitis B*

Bashkëlidhur gjeni një fletëpalosje mbi kryerjen e vaksinimit mbrojtës kundër hepatitis B. Aty përfshihen të dhënat kryesore mbi sëmundjen që shmanget nëpërmjet vaksinimit, mbi vaksinën, vaksinimin, si dhe reaksionet dhe komplikacionet e mundshme nga vaksinimi.

Anliegend erhalten Sie ein Merkblatt über die Durchführung der Schutzimpfung gegen Hepatitis B. Darin sind die wesentlichen Angaben über die durch die Impfung vermeidbare Krankheit, den Impfstoff, die Impfung sowie über Impfreaktionen und mögliche Impfkomplicationen enthalten.

Para kryerjes së vaksinimit kërkohen të dhënat shtesë si më poshtë:

Vor der Durchführung der Impfung wird zusätzlich um folgende Angaben gebeten:

1. A gëzon shëndet të plotë personi që do të vaksinohet në momentin e vaksinimit?

Ist der Impfling gegenwärtig gesund?

Po (Ja)

Jo (Nein)

2. A vuan nga ndonjë alergji personi që do të vaksinohet?

Ist bei dem Impfling eine Allergie bekannt?

Po (Ja)

Jo (Nein)

nëse po, nga cila _____

wenn ja, welche

3. A janë shfaqur te personi që do të vaksinohet shenja alergjike, temperaturë e lartë apo ndonjë reaksion i pazakontë pas një vaksinimi të mëparshëm?

Traten bei dem Impfling nach einer früheren Impfung allergische Erscheinungen, hohes Fieber oder andere ungewöhnliche Reaktionen auf?

Po (Ja)

Jo (Nein)

Nëse dëshironi të dini më shumë rreth vaksinimit mbrojtës kundër hepatitis B, pyesni mjekun e vaksinimit!

Falls Sie noch mehr über die Schutzimpfung gegen Hepatitis B wissen wollen, fragen Sie den Impfarzt!

Në takim për vaksinimin ju lutemi merrni me vete kartelën e vaksinimit!

Zum Impftermin bringen Sie bitte das Impfbuch mit!

Deklaratë miratimi*Einverständniserklärung***për kryerjen e vaksinimit mbrojtës kundër hepatitit B***zur Durchführung der Schutzimpfung gegen Hepatitis B*

Emri i personit që do të vaksinohet _____

Name des Impflings

lindur më _____

geb. am

Unë u njoha me përmbajtjen e fletëpalosjes dhe u informova në mënyrë të detajuar mbi vaksinimin në një bisedë me mjekun/mjekën time.

Ich habe den Inhalt des Merkblatts zur Kenntnis genommen und bin von meinem Arzt/meiner Ärztin im Gespräch ausführlich über die Impfung aufgeklärt worden.

Unë nuk kam pyetje të tjera.

Ich habe keine weiteren Fragen.

Unë e pranoj vaksinimin e propozuar kundër hepatitit B.

Ich willige in die vorgeschlagene Impfung gegen Hepatitis B ein.

Unë e refuzoj vaksinimin. Jam vënë në dijeni për anët negative të mundshme të refuzimit të vaksinimit.

Ich lehne die Impfung ab. Über mögliche Nachteile der Ablehnung dieser Impfung wurde ich informiert.

Shënime _____

Vermerke

Vendi, data _____

Ort, Datum

Nënshkrimi i personit që do të vaksinohet ose
i kujdestarit të tij

Unterschrift des Impflings bzw. des Sorgeberechtigten

Nënshkrimi i mjekut/mjekes

Unterschrift des Arztes/der Ärztin